

STATUTI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“DENISI KONSTRUKSION 2020” Shpk

Une **Denis Çaç** datelindjes 23.12.1994, i biri i Fiqiri -ut, banues ne Synej, i identifikuar nga leternjoftimi elektronik me nr ID. J41223042T me qe ne vijim do te quhet **“Ortak”**

Sot me date **12 /10/2020**, une ortaku i vetem e shoqerise vendosa :
Te hartoj statutin e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar

“DENISI KONSTRUKSION 2020” Shpk, ne perputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1.Objekti I shoqerise

1.2 : *Shoqeria ka kete objekt veprimtarie*: Ndertues dhe investitor ne objekte civile e industriale, turistike,bujqesore ,ndertime banesa ,ruge kategoria V-IV-III-II-I ,punime mirembajtje dhe sinjalizime ne rruge ,ndertim mbishtresa rrugore,ujesjellesa ,kanalizime,kanale impjante e vaditje ,sillose ,kulia uji prej barme e metalike ,germime dheu me punime murature e beton armeje pishina ne toke te germuar etj rikonstruksion te tyre, import- eksport te materialeve te ndertimit, tregtim te materialeve te ndertimit, hartimi e zbatimi i projekteve dhe zbatimi i tyre per qellime ndertimi, hapje e shfrytezim minierash, prodhim i perpunimi i materialeve qe perdoren per ndertim etj

1.2. Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektivave te saj.

Neni 2.Emertimi dhe Selia juridike e Shoqerise

2.1. Ortaku i vetem i shoqerise vendosi qe shoqerine ta emertojne :

“DENISI KONSTRUKSION 2020” Shpk

2.2. Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne : Kavaje ,Njesia Administrative Synej ,fshati Synej , Rruga : Synej –Bago ,Nr.pasurise 88/6 zona kadastrale 3554,vol 4 fq.236

2.3. Shoqeria mund te krijoj qendra sekondare , filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera Shqiperi ose jashte vendit.



Neni.3. Regjimi Juridik

3.1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Stautit, dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi.

3.2. Me vendimin e tij Ortaku ivetem mund te ndryshoje regjimin juridik te Shoqerise. n.q.s ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaku do te pershtase Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te beje regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe ne perputhje me ligjin

3.4. Shoqeria do te kete vulen e saj

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4. Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakeve

4.1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.

4.2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.

4.3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortake ne shoqeri ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.

4.4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj. Ajo ne asnje rast nuk pergjigjet per detyrimet e ortakut dhe as ky i fundit nuk mban pergjegjesi personale per detyrimet qe merr persiper shoqeria.

4.5. Ortaku ka te drejte te marre te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te Shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj

4.6. Ortaku perballon humbjet e shoqerise vetem dhe deri ne kufirin e vleres se kontributeve te tij ne kapitalin themeltar

Neni 5. Kohezgjatja

5.1. Kohezgjatja e Shoqerise eshte me afat te pacaktuar

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

6.1. Kapitali themeltar eshte **100.000** (njeqind mije) leke dhe eshte i ndare



ne 1 kuote me vlere nominale 100.000 leke

6.2. Ndarja e pjeseve ne kapitalin themeltar eshte :DENIS ÇAÇA , 1 kuote ,
perkatesisht 100% te kuotave

6.3. Kapitali I shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te
merren nga ortaku i vetem i shoqerise

6.4. Ky kapital nuk mund te jete me i vogel se minimumi i perezaktuar me ligj.

Neni 7- Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar

7.1. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me vendim te ortakut te
vetem

7.2. Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen, nga ortaku , personave te trete,
qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e ortakut te vetem

Kreu IV

DREJTIMI DHE ORGANET KRYESORE

Neni 8

8.1. Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e rregjistrimit te saj ne Qendren
Kombetare te Biznesit.

8.2. Emertimi I shoqerise tregtare, kapitali themeltar, NIPT-i duhet te jene te
permendura ne te gjitha aktet dhe dokumentat qe nxjerr kjo shoqeri dhe ju drejtohen te
treteve.

8.3. Organet kryesore te shoqerise jane: Asambleja e Pergjithshme e perbere nga
ortaku i vetem dhe administratori

Neni 9

Asambleja e Pergjithshme e shoqerise

Asambleja e pergjithshem perbehet nga ortaku i vetem e shoqerise qe eshte organi
me i larte vendimmarres I shoqerise dhe vendimet e tij jane te detyrueshme.

Te drejtat dhe detyrime t e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga ortaku i vetem qe
eshte organi me i larte vendimmarres i shoqerise dhe vendimet e tij jane te
detyrueshme . Te drejten e thirrjes se Asamblese e kane Administratori, Eksperti

kontabel i autorizuar ose ortaku i vetem . Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike.

Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin,daten,oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vonë se shtate dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Ortaku mund te perfaqesohen ne asamble mepermjet nje perfaqesuesi,duke qene i autorizuar me procure te posacme,dhe te marrin vendime vetem per ato ceshtje qe diskutohen ne mbledhjen per te cilen ata kane marre te drejten e perfaqesimit.

Mbledhjet e asamblese pasqyrohen ne procesverbalin qe mbahet me kete rast,ndersa vendimet nenshkruhen nga ortaku i vetem

Procesverbalet e mbledhjeve ruhen ne seline e shoqerise.

Te gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve,te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Ortaket i vetem i shoqerise kane te drejte te marre vendime per ceshtjet e meposhtme:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- b) Ndryshime e statutit
- c) Emerimin e shkarkimin e administratoreve
- ç) Emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- d) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronja "e" dhe "v" te kesaj pike.
- dh) Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- ë) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- f) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- g) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- gj) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- h) Miratimin e regullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- i)Çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

ii

Kreu V
ADMINISTRIMI

Neni 10

10.1. Shoqëria do të administrohet nga 1 (një) administrator i vetëm, i cili mund të zgjidhet edhe jashtë ortakeve të shoqërisë

10.2. Administratori emërohet dhe shkarkohet nga Ortaku i vetëm

10.3. Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga **Administratori z. DENIS ÇAÇA**

10.4. Kohezgjatja në detyrë e administratorit të shoqërisë do të jetë 5 (pese) vjet me të drejtë ripërtëritje në përfundim të mandatit

10.5. Administratori i vetëm i ka të gjitha të drejtat e fuqitë për drejtimin e zakonshëm të shoqërisë, me qëllim arritjen e objektivave të saj

10.6. Administratorit i takon firma e lirë dhe përfaqësimi i shoqërisë ndaj të treta në veprime, procedura dhe seanca gjyqësore, arbitrazhi ose administrative.

10.7. Administratori është përgjegjës, sipas rastit, ndaj shoqërisë ose të treta për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo dëme të kryera gjatë ushtrimit të detyrës

10.8. Kompetencat kryesore të administratorit në shoqëri janë:

- kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga ortaket ;
- përfaqëson shoqërinë tregtare
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabel të shoqërisë
- përfaqëson dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecures se veprimtarisë dhe se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqet këto dokumente përpara ortakeve për miratim
- krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë
- kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendren Kombëtare të Regjistrimit
- raporton përpara asamblese në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare
- kryen detyra të përcaktuara në ligj dhe statut
- administrimin e pasurisë së Shoqërisë, duke përfshirë mjetet financiare, brenda çaqeve të lejuara nga ortaket
- kryerjen e të gjitha veprimeve bankare në interes të shoqërisë



- te përfaqësojë Shoqërinë me të tretet në të gjithë veprimtarinë e saj dhe të mbrojë interesat e saj në gjykatë apo arbitrazh, në shkëmbim të kontratave në emër të shoqërisë dhe ndjekjen e zbatimit të tyre;
- të propozojë asamblese për miratim strukturën e aparatit të Shoqërisë dhe krijimin e organeve të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të Shoqërisë;
- të propozojë asamblese për miratim numrin e punonjësve të Shoqërisë, pagat dhe emerimin e shkarkimin e tyre

Neni 11-Marreveshjet e ndaluara

11.1.Administratorit ose ortakut që nuk janë persona juridike nuk u lejohej të kontraktonte në çfarëdo lloji forme qofte, të marrin hua të shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradheme si dhe të behen dorezues apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tjerëve .Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.Kjo masë ndaluese zbatohet edhe ndaj përfaqësuesve ligjore të ortakëve që janë persona juridike.

11.2.Kjo masë zbatohet gjithashtu ndaj bashkeshortëve, paraardhësve dhe pasardhësve të personave të cituar në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe ndaj çdo personi ndërmjetes

Kreu VI

VITI FINANCIAR , LLOGARITE VJETORE,NDARJA E FITIMEVE

Neni 12

12.1.Çdo vit financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.Përjashtimisht viti I parë I cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Biznesit.

12.2.Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar , raportet e vecanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht eksperti kontabel I autorizuar, miratohen nga Ortaku i vetëm

12.3.Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar

Neni 13-Kontrolli i Shoqërisë

13.1.Kontrolli i Shoqërisë kryhet nga një Ekspert Kontabel i Autorizuar, I emëruar nga ortakut i vetëm .

13.2.Eksperti kontabel i autorizuar garanton që llogarite vjetore të shoqërisë janë të rregullta, të hartuara me sinqeritet dhe pasqyrojnë rezultatet e vitit të kaluar financiar .

si dhe gjendjen financiare te shoqerise. Ai verifikon librat e llogarive, si dhe fondet e shoqerise , kontrollon pershtatjen e kontabilitetit me ligjin ne fuqi, verifikon perputhjen me llogarite vjetore te informacionit te dhe ne raportin e administrimit, kontrollon gjithe librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe regjistrat e proces-verbaleve. Mund te aktivizojte eksperte dhe bashkepunatore per te perballuar volumin e punes, por duke marre me pare miratimin e ortakeve.

13.3. Shkarkimi i Ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kushte si emerimi nga ana e asamblese.

Kreu VII

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 14

14.1. Shoqeria mund te priset ne çdo kohe dhe per çfare do lloj shkakut, si ne rast falimentimi, privim te te drejtave per te ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga Ortaku

14.2. Shoqeria hyn ne fazen e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj .Per kryerjen e ketij procesi, asambleja emerone nje ose disa likujdatore, te cilet i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e aktivitet dhe pasivitet te Shoqerise , mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe afatin e nevojshem te perfundimit te tyre

14.3. Ne fund te procesit te likujdimit, ortaku vendos mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise se punes se likuduesit, dhe mbylljen e procesit te likujdimit.

14.4. Pas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapilit themeltar tek kontribuesit perkates, likujdatori ndan kapitalet e mbetura per ortakun e vetem te shoqerise.

Neni 15. Zgjidhja e mosmarrveshjeve

15.1. Mosmarrveshjet midis ortakut , shoqerise dhe te treteve ne rast se nuk zgjidhen me mirekuptim, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor.

Kreu VIII

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 16

16.1. Per sa nuk eshte e parashikuar ne kete Statut , do t'i behet referim ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", si dhe legjislacionit koherent

16.2. Ky statut hartohet ne 4 (kater) kopje, secila me te njejten vlere ligjore. Njera prej kopjeve ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

“

ORTAKUVETEM I SHOQERISE
“DENISI KONSTRUKSION 2020” SH.P.K

DENIS ÇAÇA

